



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:137634
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05638582

CAP.nr.1748/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Hidajete Gashi Alaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit B.N, të cilën e përfaqëson i autorizuari S.K, avokat në Prishtinë, kundër debitorit SHSKUK-QKUK në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbarimore, për shkak të borxhit, në vlerë prej 717.88 euro, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit B.N, av. S.K, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1955/20, i datës 06.10.2023, me datën 29.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit B.N, av. S.K, nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr. 1955/20, i datës 06.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr. 1955/20, i datës 06.10.2023 e ka aprovuar prapësimin e debitorit SHKUK –QKUK Prishtinë, dhe është anuluar urdhri përmbarimor, P.nr.1337/20, i datës 28.05.2020 i lejuar nga përmbaruesi privat A.M në Prishtinë, si dhe është refuzuar i pabazuar propozimi për përmbarim.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, kreditori përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit, që ankesën e kreditorit ta aprovoj si të bazuar, te priset aktvendimi i atakuar dhe ta detyroj debitorin që t’ia paguaj kreditorit borxhin sipas propozimit për përmbarim. Po ashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës.

Debitori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e kreditorit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 28.05.2020, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit në bazë të titullit ekzekutiv - Vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94, të datës 10.02.2020, i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm me datën me datën 19.05.2020, dhe vendimit nr.303/2020, të datës 19.05.2020, të paraparë më gjerësisht si në propozimin për përmbartim.

Përmbartuesi Privat A.M ka nxjerr urdhrin P.nr.1337/20, të datës 28.05.2020, me të cilin e ka lejuar propozimin për përmbartim.

Pas pranimit të urdhrin, debitori ka paraqitur prapësim me propozim që të aprovohet prapësimi si i bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1955/20, i datës 06.10.2023, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur i autorizuari i kreditorit B.N, av, S.K, duke propozuar që të refuzohet si i pabazuar prapësimi, të vërtetohet urdhri përmbartimor P.nr.1337/20, të datës 28.05.2020 dhe të detyrohet debitori që kreditorit t'ia paguajë borxhin dhe shpenzimet e avokatit.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata ka theksuar se analizimit dhe vlerësimit të Urdhrit për përmbartim, ka gjetur se i njëjti, është lejuar mbi bazën e një dokumenti-akti administrativ i cili nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe nuk është i përshtatshëm për përmbartim andaj edhe gjeti se prapësimi është i bazuar. Me Nenin 27.1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore është përcaktuar se *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit”*

Gjykata e shkallës së parë vlerëson se në këtë rast titull përmbartues është përdorë vendimi 01.Nr.21-1715/94, datë 10.02.2020, mbi bazën e të cilit është iniciuar procedura e përmbartimit dhe është kërkuar që të realizohet kërkesa e përmbartur në të, ndërsa me asnjë veprim të mëvonshëm, duke përfshirë edhe nxjerrjen e vendimit të quajtur si korrigjues, nuk mundet zëvendësohet titulli përmbartues mbi bazën e të cilit është iniciuar procedura e përmbartimit, siç është bërë përpjekje në këtë rast nga përmbartuesi privat.

Përveç kësaj, gjykata e shkallës së parë vlerëson se me vendimin korrigjues inspektorati i punës nuk ka bërë korrigjim të vendimit ashtu siç theksohet dhe ashtu siç përcaktohet me nenin 50, paragrafi 1 Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në të cilën dispozitë thuhet se: “Organi publik, në çdo kohë, sipas detyrës zyrtare apo sipas kërkesës, mund të korrigjojë gabimet drejtshkrimore, gabimet në përlogaritje dhe pasaktësi të tjera të ngjashme, të dukshme, në një akt administrativ”. Nëse shikojmë vendimin e parë për të cilin pretendohet se është korrigjuar, rezulton se nuk është bërë asnjë korrigjim i vendimit ashtu siç është përcaktuar me dispozitën e lartë cituar por se mund të nxirret përfundimi se në këtë rast Inspektorati i Punës ka marr vendim plotësues ngase është vendos për diçka që nuk është vendos në vendimin e parë. Ligji i sipërcituar në asnjë dispozitë të tij nuk parasheh situatën kur organi administrativ mund të merr vendim plotësues dhe në raste të tilla kur paraqitet nevoja e nxjerrjes së një vendimi plotësues, në mungesë të dispozitave në procedurë administrative për këtë çështje, duhet që të aplikohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), përkatësisht nenin 162, paragrafin 1.2 dhe 3 të LPK-së, me të cilin përcaktohet se: “Po që se gjykata nuk ka vendosur mbi të gjitha kërkesat që është dashur të përfshihen me aktgjykim, ose kur vetëm një pjesë e kërkesës ka mbetur pa u përfshirë me të, pala mundet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur i është dorëzuar aktgjykimi t’i propozojë gjykatës që të bëjë plotësimin e tij. Po që se pala nuk paraqet propozim për plotësimin e aktgjykimit do të konsiderohet se padia është tërhequr në pjesën që ka mbetur pa u përfshirë me aktgjykimin e dhënë. Propozimi i vonuar apo i pathemeltë për plotësimin e aktgjykimit, hidhet poshtë përkatësisht refuzohet nga gjykata pa u caktuar seancë gjyqësore”. Ky vendim edhe si vendim plotësues nuk mund të shërbejë si titull përmbarues kjo pasi që është marrë pa propozimin e palës si dhe është marrë jashtë afatit ligjore prej 15 ditësh.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura gjykata vlerëson se është dashur të vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi ngase në këtë rast nuk ka pasur kushte ligjore të iniciohet procedura e përmbarimit dhe të lejohet përmbarimi nga përmbaruesi privat, kjo pasi që vendimi administrativ në bazë të cilit është iniciuar procedura përmbarimore dhe është lejuar përmbarim dhe ai i nxjerr më vonë si vendim korrigjues nuk mund të konsiderohen titull përmbarues ashtu siç është përcaktuar me dispozitat nga nenet 21, 27 dhe 36 të LPP-së..

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe Gjykata ankimore i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata e Apelit gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se të njëjtat janë të pa bazuara, për faktin se fillimisht kjo Gjykatë vlerëson se nuk ekzistojnë shkeljet e pretenduara nga neni 182.2 pika n) e LPK-së për faktin se dispozitivi i aktvendimit është i qartë, kuptueshëm si dhe

në përputhje me arsyet e aktvendimit e po ashtu edhe arsyet e dhëna janë të qarta me vetë dispozitivin e aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit gjatë shikimit të shkresave të lëndës, vëren se dokumenti në bazë të së cilit është bërë propozimi për përmbarrim është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm dhe kjo rezulton të provohet nga vula e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë, të stampuara në vendimin në bazë të cilit është bërë propozimi për përmbarrim. Por, përkundër faktit se dokumenti përmbarrimor përmban vulën e plotfuqishmërisë dhe të ekzekutueshmërisë, kjo Gjykatë gjen se dokumenti nuk është i përshtatshëm për përmbarrim për faktin se nuk i përmban elementet e përcaktuara me dispozita ligjore për tu konsideruar si dokument përmbarrimor.

Neni 27 i LPP-së, në mënyrë shprehimore parasheh se “*dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftëse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bën dokumentin përkatës përmbarrimor të papërshtatshëm për përmbarrim.

Nga shikimi i shkresave të lëndës, për këtë Gjykatë rezulton të provohet fakti se dokumenti përmbarrimor –vendimi administrativ i Inspektoriatit të Punës, 01Nr.21-1715/94, i datës 10.02.2020, në dispozitiv të tij nuk e përmban shumën e detyrimit, e që nënkupton se dokumenti në fjalë nuk mund të konsiderohet si i përshtatshëm për tu përmbarruar sepse është në kundërshtim me dispozitata e LPP-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë nga pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1748/2023, me datën 29.04.2024

Gjyqtarja
Hidajete Gashi Alaj, d.v.